



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
ZEVENDËSMINISTRI

Nr. 5121 Prot.

Tiranë, më 17.12.2021

UDHËZUES

Nr 551 datë 17.12. 2021

PËR

**MËNYRËN E ZBATIMIT TË PROCEDURAVE TË SHTRIMIT DHE
TRAJTIMIT NË SHËRBIMET E SHËNDETIT MENDOR TË SPECIALIZUAR
ME SHTRETËR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 19, pikës 2 të nenit 19/1, pikës 4 të nenit 20 dhe pikës 6 të nenit 24/1, të Ligjit Nr. 44/2021, “Për shëndetin mendor”, të ndryshuar” dhe Autorizimit Nr. 6144 prot., datë 25.10.2018,

Udhëzoj:

A. TË PËRGJITHSHME

1. Autoritetet shtetërore, përgjegjëse për ofrimin shërbimive të shëndetit mendor, të marrin të gjitha masat për ofrimin e kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor në zbatim të të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor, në përputhje me aktet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe të parimeve të përgjithshme të kujdesit, si:
 - a. Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime të shëndetit mendor, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor.
 - b. Ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor në një mjedis sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur në maksimum zhvendosjet nga mjedisi familjar e për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social.
 - c. Krijimi i lehtësive për këta persona dhe familjet e tyre, me qëllim përfshirjen e tyre në jetën shoqërore.
 - d. Ofrimi i kujdesit për personat me çrregullime të shëndetit mendor nga ekipe multidisiplinare që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit.

2. Në zbatim të parimeve të mësipërme të sanksionuara në kuadrin ligjor në fuqi në fushën e shëndetit mendor, kujdesi shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor ofrohet në një mjedis sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar.

B. PROCEDURAT E SHTRIMIT NË SHËRBIMET E SHËNDETTIT MENDOR TË SPECIALIZUAR ME SHTRRETËR.

1. Shtrimi i personit me çrregullime të shëndetit mendor në një shërbim të shëndetit mendor të specializuar me shtretër referohet nga mjeku në shërbimet komunitare ose shërbimet ambulatorë të specializuara në shëndetit mendor, vetëm në rastet kur mundësitë ekzistuese për trajtimin e tij shëndetësor në komunitet janë shteruar dhe mjekimi i nevojshëm jepet vetëm nëpërmjet shtrimit në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, në përputhje me parimet e alternativës sa më pak kufizuese, si dhe nuk mund të shërbejë për asnjë rast për qëllim të shqyrtimit të aftësisë për punë. Shtrimi në një shërbim të shëndetit mendor të specializuar me shtretër mund të jetë “i vullnetshëm” ose “i pavullnetshëm”.
2. Në kuptim të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor termat e mëposhtme kanë këto kuptime:
 - a. ***Shtrimi i vullnetshëm***, është shtrimi në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër i një personi me çrregullime të shëndetit mendor, me qëllim ofrimin e kujdesit të duhur shëndetësor dhe trajtimin e nevojshëm, pas dhënies së miratimit të informuar.
 - b. ***Miratim i informuar***, është miratimi i marrë nga një person për përfshirjen ose jo të tij në një procedurë të vlerësimit të nevojave të tij, marrjen ose jo të një shërbimi që plotëson nevojat e tij, vetëm pasi personi është informuar në mënyrë të plotë për procedurën, shërbimin dhe alternativat e tjera për vlerësimin dhe plotësimin e nevojave të tij.
 - c. ***Shtrimi i pavullnetshëm***, është shtrimi i një personi që vuan nga një çrregullim serioz i shëndetit mendor, që kryhet pa miratimin e tij dhe konfirmohet nëpërmjet një vendimi gjyqësor.
 - d. ***Trajtimi***, është tërësia e veprimtarive të vlerësimit, diagnostikimit, trajtimit dhe rehabilitimit, që përfshin marrëdhëniet, ndërmjet pacientit dhe ekipit multidisciplinar të institucioneve të kujdesit për shëndetin mendor dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në kujdesin shëndetësor, mund të jetë i natyrës së “vullnetshme” dhe “të pavullnetshme”.

- e. **“Trajtimi i vullnetshëm”**, është trajtimi me kërkesë ose miratim të personit që vuan nga çrregullime të shëndetit mendor ose me kërkesë të përfaqësuesit ligjor të të miturit nën moshën 14 vjeç.
 - f. **“Trajtimi i pavullnetshëm”**, është trajtimi që i ofrohet një personi që vuan nga një çrregullim serioz i shëndetit mendor pa miratimin e tij, i propozuar nga mjeku specialist, vetëm pasi ky mjek të ketë kryer personalisht vlerësimin e pacientit dhe kur plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:
 - i. kur ka një çrregullim të rëndë mendor;
 - ii. nuk ka aftësinë e duhur për të dhënë miratimin e informuar;
 - iii. trajtimi është i nevojshëm për përmirësimin e gjendjes së shëndetit mendor dhe/ose për të rifituar aftësinë për dhënien e miratimit për trajtimin dhe/ose për të parandaluar përkeqësimin ose dëmtimin e shëndetit të tij ose të të tjerëve, dhe
 - iv. konfirmohet nëpërmjet një vendimi gjyqësor.
3. Miratimi i informuar sigurohet nëpërmjet diskutimit në mënyrë të përshtatshme me pacientin për nevojën e shtrimit të tij, me qëllim sigurimin e kujdesit dhe trajtimin e duhur shëndetësor dhe përdorimin e formularit tip të miratimit të informuar, ku përmbajtja e diskutimit dhe formulari i miratimit të informuar janë pjesë e kartelës klinike të pacientit.
4. Pacienti firmos për dhënien e miratimit për shtrim si në kartelë, ashtu edhe në formularin e miratimit të informuar (**Aneks I “Deklaratë Pranimi/Miratimi “Për shtrimin në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër”**).
5. Procedura e shtrimit të pavullnetshëm zbatohet në rastet kur personi, pas informimit të plotë dhe të përshtatshëm, nuk miraton shtrimin në një shërbim të shëndetit mendor të specializuar me shtretër ose, pasi është shtruar në mënyrë të vullnetshme, mbahet në mënyrë të pavullnetshme, sipas përcaktimit të mjekut specialist, pasi plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:
- a. kur ka një çrregullim të rëndë mendor;
 - b. personi rrezikon jetën, shëndetin ose sigurinë e vetes ose të të tjerëve dhe pa trajtimin e duhur gjendja e shëndetit mendor rrezikon të përkeqësohet;
 - c. shtrimi duhet të bëhet për qëllime terapeutike;
 - d. janë shteruar mundësitë ekzistuese për trajtimin shëndetësor në komunitet dhe mjekimi i nevojshëm jepet vetëm nëpërmjet shtrimit në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, në përputhje me parimet e alternativës sa

- më pak kufizuese dhe nuk mund të shërbejë për asnjë rast për qëllim të shqyrtimit të aftësisë për punë.
6. Procedurat e shtrimit të pavullnetshëm zbatohen edhe për personat me çrregullime të shëndetit mendor që nuk kanë zotësi për të vepruar, të cilët nuk japin miratimin e informuar për shtrim në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, pavarësisht mendimit të kujdestarit të tij ligjor, në të njëjtat kushte si personat me çrregullime të shëndetit mendor me zotësi të plotë për të vepruar.
 7. Vendimi për shtrim të pavullnetshëm të një personi me çrregullime të shëndetit mendor merret nga mjeku specialist, vetëm pasi ai të ketë kryer personalisht ekzaminimin e personit dhe informon menjëherë personelin mjekësor ose policor që e ka shoqëruar, familjarët dhe personat e tjerë që e shoqërojnë, si dhe përfaqësuesin ligjor, nëse është i pranishëm. Personi gëzon të drejtën të komunikojë me personat pranë tij apo përfaqësuesin e tij ligjor. Mjeku specialist që vendos për shtrimin e pavullnetshëm, përshkruan në mënyrë të hollësishme në kartelën mjekësore të gjitha procedurat e ndjekura dhe siguron njoftimin e shefit të shërbimit për shtrimin e pavullnetshëm, brenda 24 orëve.
 8. Shefi i shërbimit, jo më vonë se 24 orë nga shtrimi i pavullnetshëm, urdhëron me shkrim në kartelën mjekësore rivlerësimin e gjendjes shëndetësore të personit të shtruar në mënyrë të pavullnetshme dhe ky rivlerësim kryhet nga personeli mjekësor, që nuk ka marrë pjesë në procedurën fillestare të shtrimit.
 9. Pas rivlerësimit të gjendjes shëndetësore, personeli mjekësor plotëson kartelën mjekësore me të gjitha shënimet e nevojshme dhe referon pranë shefit të shërbimit nëse shtrimi i pavullnetshëm është i bazuar apo i pabazuar, ose kanë rënë shkaqet që personi të mbahet në kushte të tilla.
 10. Në rast se pas rivlerësimit, shefi i shërbimit konstaton se kanë rënë shkaqet që personi të mbahet në kushte shtrimi të pavullnetshëm, urdhëron nxjerrjen e menjëhershme të personit nga shtrimi i pavullnetshëm. Vendimi i shefit të shërbimit dhe arsyet e tij shënohen në mënyrë të hollësishme në kartelën mjekësore.
 11. Në rast se pas rivlerësimit, shefi i shërbimit konstaton se nuk kanë rënë shkaqet që personi të mbahet në kushte shtrimi të pavullnetshëm, personi vazhdon të mbahet në mënyrë të pavullnetshme në këtë shërbim.
 12. Të gjitha hapat e mësipërme proceduralë dokumentohen (**Aneks II** “Formulari Tip A1 “Formularin për shtrim të pavullnetshëm”) dhe secili profesionist i përfshirë nënshkruan ndërhyrjen.

13. Pas këtij vendimi, brenda 48 orëve, titullari i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, referuar nga shefi i shërbimit, i drejtohet gjykatës së rrethit gjyqësor për të vlerësuar procedurën e kryer (**Aneks III** “Formulari Tip A2 “Kërkesë Gjykatës Kompetente për shqyrtim të vendimit për shtrim të pavullnetshëm”) dhe një kopje e kërkesës u vihet në dispozicion pacientit, një familjari të afërt dhe/ose përfaqësuesit të tij ligjor.
14. Gjyqtari i vetëm e shqyrton kërkesën e paraqitur nga titullari i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, për vlerësimin e shtrimit të pavullnetshëm duke marrë mendimin e një mjeku specialist të një institucioni të pavarur nga institucioni ku është shtruar, si dhe dëgjon personalisht pacientin, jo më vonë se 48 orë nga paraqitja e saj dhe vendimi i tij zbatohet menjëherë nga shërbimi i specializuar i shëndetit mendor me shtretër, me kushtin e rishikimit në mënyrë periodike çdo 28 ditë, me kërkesë të titullarit të institucionit ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor i specializuar me shtretër.
15. Në çdo çast para përfundimit të rishikimit periodik 28 ditor, kur kanë rënë shkaqet shëndetësore që çuan në shtrim të pavullnetshëm, titullari i institucionit ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, vetë personi me çrregullime të shëndetit mendor, subjekt i shtrimit të pavullnetshëm, familjarët ose përfaqësuesi ligjor i tij, parashetrojnë në gjykatën kompetente kërkesën për revokimin e vendimit të gjykatës.
16. Vetë personi subjekt i procedurës së shtrimit të pavullnetshëm dhe familjarët e tij të afërt ose kujdestari ligjor, gëzojnë të drejtën të informohen brenda 48 orëve për shkaqet e marrjes së këtij vendimi dhe për të drejtat që pacienti gëzon në këtë gjendje (**Aneks IV** “Formulari TIP A3 “Informimi i pacientit për shtrimin e pavullnetshëm”).

C. PROCEDURAT E TRAJTIMIT NË SHËRBIMET E SHËNDETIT MENDOR TË SPECIALIZUAR ME SHTRETËR.

1. Personi me çrregullime të shëndetit mendor, i shtruar në mënyrë të vullnetshme ose jo në një shërbim të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, merr trajtim të vullnetshëm pas lëshimit të miratimit me shkrim nga ana e tij, me kusht informimin paraprak nëpërmjet ofrimit të informacionit të plotë dhe të përshtatshëm ndaj pacientit për natyrën, qëllimin dhe efektet e ndërhyrjes terapeutike të propozuar, e dokumentuar në formularin tip të miratimit të informuar të trajtimit të vullnetshëm (**Aneks V** “Deklaratë Miratimi Trajtimi në

- shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër”). Miratimin për të miturit e lëshon kujdestari ose përfaqësuesi i tyre ligjor.
2. Përmbajtja e diskutimit dhe formulari i miratimit të informuar janë pjesë e kartelës klinike të pacientit dhe pacienti firmos për dhënien e miratimit si në kartelë, ashtu edhe në formularin e miratimit të informuar.
 3. Personi me çrregullime të shëndetit mendor, kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor kanë të drejtë të kërkojnë ndërprerjen, refuzimin ose të ankohen për trajtimin në çdo moment të procesit, gjë e cila mund të kundërshtohet vetëm kur përmbushen kriteret për trajtim të pavullnetshëm.
 4. Vendimi për trajtim të pavullnetshëm të një personi me çrregullime të shëndetit mendor merret nga mjeku specialist, vetëm pasi ai të ketë kryer personalisht ekzaminimin e personit dhe informon vetë personin subjekt i procedurave të trajtimit të pavullnetshëm, familjarët e afërt, si dhe përfaqësuesin ligjor, nëse është i pranishëm, mbi shkaqet e marrjes së këtij vendimi dhe të drejtën që pacienti për të komunikuar me personat pranë tij ose përfaqësuesin e tij ligjor. Mjeku specialist që vendos për trajtimin e pavullnetshëm, përshkruan në mënyrë të hollësishme në kartelën mjekësore të gjitha procedurat e ndjekura dhe siguron njoftimin e shefit të shërbimit për trajtimin e pavullnetshëm, brenda 24 orëve.
 5. Shefi i shërbimit, jo më vonë se 24 orë nga vendosja në trajtim të pavullnetshëm, urdhëron me shkrim në kartelën mjekësore rivlerësimin e gjendjes së pacientit dhe planin e tij të trajtimit dhe ky rivlerësim kryhet nga personeli mjekësor, që nuk ka marrë pjesë në procedurën fillestare të trajtimit të pavullnetshëm.
 6. Pas rivlerësimit të gjendjes së pacientit dhe planit të trajtimit të personit subjekt i trajtimit të pavullnetshëm, personeli mjekësor plotëson kartelën mjekësore me të gjitha shënimet e nevojshme dhe referon pranë shefit të shërbimit për gjendjen e pacientit dhe nëse është dakord ose jo me planin e tij të trajtimit.
 7. Në rast se pas rivlerësimit shefi i shërbimit konstaton se nuk përmbushen kriteret për trajtimin e pavullnetshëm, urdhëron nxjerrjen e menjëhershme të personit nga ky trajtim. Vendimi i shefit të shërbimit dhe arsyet e tij shënohen në mënyrë të hollësishme në kartelën mjekësore.
 8. Në rast se pas rivlerësimit, shefi i shërbimit konstaton se trajtimi i pavullnetshëm duhet të vazhdohet sipas planit të trajtimit të dakordësuar nga dy vlerësimet e pavarura nga njëra-tjetra, personi vazhdon të trajtohet në mënyrë të pavullnetshme në këtë shërbim.

9. Të gjitha hapat e mësipërme proceduralë dokumentohen (**Aneks VI** “Formular Tip A1 për trajtimin e pavullnetshëm”) dhe secili profesionist i përfshirë nënshkruan ndërhyrjen.
10. Pas këtij vendimi, brenda 48 orëve, titullari i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, referuar nga shefi i shërbimit, i drejtohet gjykatës së rrethit gjyqësor për të vlerësuar procedurën e kryer (**Aneks VII** “Formulari TIP A2 “Kërkesë Gjykatës Kompetente për shqyrtim të vendimit për shtrim të pavullnetshëm” dhe një kopje e kërkesës u vihet në dispozicion pacientit, një familjari të afërt dhe/ose përfaqësuesit të tij ligjor.
11. Gjyqtari i vetëm e shqyrton kërkesën e paraqitur nga titullari i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, për vlerësimin e trajtimit të pavullnetshëm, duke marrë mendimin e një mjeku specialist të një institucioni të pavarur nga institucioni ku është shtruar, si dhe dëgjon personalisht pacientin, jo më vonë se 48 orë nga paraqitja e saj dhe vendimi i tij zbatohet menjëherë nga shërbimi i specializuar i shëndetit mendor me shtretër, me kushtin e rishikimit në mënyrë periodike çdo 28 ditë, me kërkesë të titullarit të institucionit ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor i specializuar me shtretër.
12. Në çdo çast para përfundimit të rishikimit periodik 28 ditor, kur nuk përmbushen kriteret për trajtimin e pavullnetshëm, titullari i institucionit ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, vetë personi me çrregullime të shëndetit mendor, subjekt i shtrimit të pavullnetshëm, familjarët ose përfaqësuesi ligjor i tij, parashtrajnë në gjykatën kompetente kërkesën për revokimin e vendimit të gjykatës.
13. Vetë personi subjekt i procedurës së trajtimit të pavullnetshëm dhe familjarët e tij të afërt ose kujdestari ligjor informohen brenda 48 orëve për shkaqet e marrjes së këtij vendimi dhe për të drejtat që pacienti gëzon në këtë gjendje (**Aneks VIII** “Formulari TIP A3 “Informimi i pacientit për trajtim të pavullnetshëm”).

Ky udhëzues hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI



MIRA BAKACOLLI

DEKLARATË MIRATIMI TRAJTIMI

Pas shtrimit tim në shërbimin shëndetit mendor të specializuar me shtretër _____, mjeku im kurues _____ më ka informuar mbi planin tim të trajtimit dhe e jap miratimin tim që të trajtohem sipas këtij plani. Unë pranoj të ndjek me përpikmëri planin e trajtimit që më rekomandon mjeku, me qëllim zvogelimin apo largimin e simptomave të sëmundjes sime. Më është shpjeguar se mënyra e trajtimit e përzgjedhur për mua është në përputhje me diagnozën dhe me llojin e shërbimeve, që mund të ofrojë ky Shërbim, dhe se suksesi i trajtimit tim varet nga eksperiencat e mëparshme me këto trajtime në parandalimin e rikthimit të simptomave, nga karakteristikat e sëmundjes time dhe nga faktorë të tjerë. Tashmë më është shpjeguar mjaft qartë arsyeja pse më është rekomandur kjo mënyrë trajtimi, se cila do të jetë procedura e aplikimit të trajtimit tim në kushte spitalore, cilat do të jenë medikamentet që do të përdoren, koha që do të duhet të pritët për të parë efektin pozitiv të tyre dhe efektet e mundshme anësore. Mjeku, gjithahstu, më ka shpjeguar se ecuria e trajtimit do të ndiqet në mënyrë të rregullt prej personelit të mjekëve dhe infermierëve, të paktën një herë në 24 orë, dhe se për çdo shqetësim apo kërkesë unë mund t'i drejtohem në çdo kohë infermierit të turnit i cili/a do t'ia përcjellë ato mjekut në afatin më të shkurtër. Pritet që plani i trajtimit të përmirësojë gjendjen time të shëndetit mendor. Ndonëse për pjesën më të madhe të pacientëve trajtimi i përdorur në këtë mënyrë është efektiv, unë e kuptoj se kjo nuk mund të jetë plotësisht e garantuar. Me vazhdimin e trajtimit, nga informacioni i dhënë, unë mund të jem përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme apo mund të kem një sasi të pjesshme ose të plotë të simptomave psikiatrike. Ashtu si pjesa më e madhe e trajtimeve spitalore edhe trajtimi që do të aplikohet tek unë paraqet rrezikun e shfaqjes së efekteve anësore. Për të zvogëluar rrezikun e komplikacioneve, mua do të më bëhet periodikisht një vlerësim mjekësor. Barnat që unë kam pasë marrë mund të ndërrohen. Gjithsesi, megjithë masat e marra, mundet që unë të kem ndonjë komplikacion mjekësor dhe ka një mundësi shumë të vogël që këto komplikacione mund të jenë aq të rënda sa mund të rrezikohet jetën. Nëse ndodhin efekte anësore serioze, unë e di që do të më ofrohet menjëherë trajtimi dhe kujdesi i duhur, dhe se janë mjetet e nevojshme për të përballuar ndonjë urgjencë. Gjithsesi unë e kuptoj se si institucionit, ashtu edhe mjekëve kurues iu duhet të aplikojnë trajtim afatgjatë. Unë kuptoj se nuk do të ketë asnjë kompesim nga Shërbimi për humbjen e ditëve të mia të punës apo të pasojave të tjera. Kufizimet në aktivitetin tim, si p.sh ngarja e mjeteve motorike apo biçikletës, mund të jenë për një kohë më të gjatë, në varësi të planit tim të trajtimit dhe këto do të diskutohen me mjekun tim në vazhdimësi. Vendimi im për të pranuar trajtimin në shërbimin shëndetit mendor të specializuar me shtretër _____, është marrë me vullnetin tim të plotë, dhe unë mund ta anulojë aprovimin tim kurdoherë në të ardhmen. Mua më është dhënë një kopje e këtij formulari pranimit.

Data _____

Personi që jep aprovimin

Emri _____

Firma _____

SHËRBIMI I SHËNDETIT MENDOR I SPECIALIZUAR ME SHTRETËR

Formular Tip A1

FORMULAR PËR TRAJTIM TË PAVULLNETSHËM

EMRI DHE MBIEMRI (me shkronja shtypi)

Nr. Regjistri.	

Data: _____

Ora: _____

Burimi i referimit:

Emri dhe kodi i personit referues: _____

- | | |
|---------------|----------------------|
| 0. N.D | 5. Policia |
| 1. Pacienti | 6. Mjeku i familjes |
| 2. Familjarë | 7. Psikiatër |
| 3. Fqinj | 8. Specialist tjetër |
| 4. Vetë stafi | 9. Të tjerë |

Zotësia për të vepruar:

Po Jo N.D

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------	--------------------------

ARSYET PËR TRAJTIM NË SHËRBIM ME SHTRETËR:

Firma e mjekut specialist _____

GJENDJA AKTUALE DHE PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PLANIT TË TRAJTIMIT:

Mjeku specialist, Dr. _____, pasi ka kryer personalisht ekzaminimin rekomandoi planin e mësipërm të trajtimit, por pacient e refuzoi atë. Meqënëse pacienti paraqet rrezikshmëri për veten apo të tjerët, dhe përmbush kriteret në bazë të Ligjit 44/2012, i ndryshuar, vendos trajtimin e pavullnetshëm dhe merr përsipër njoftimin e shefit të shërbimit brenda 24 orëve nga kryerja e vlerësimit fillestar.

Data: _____

Ora: _____

Firma: _____

RIVLERËSIMI I VENDIMIT PËR TRAJTIM TË PAVULLNETSHËM:

Shefi i shërbimit Dr. _____, udhëron mjekun specialist Dr. _____, për rivlerësimin e gjëndjes shëndetësore.

Data: _____ Ora: _____ Firma: _____

Mjeku specialist, Dr. _____ pasi ka kryer personalisht rivlerësimin e gjëndjes shëndetësore, konstatoi se trajtimi i pavullnetshëm i vendosur nga mjeku i parë, është:

I bazuar

I papabazuar

Kanë rënë shkaqet

Data: _____

Ora: _____

Firma: _____

Nëse pas rivlerësimit, trajtimi i pavullnetshëm vlerësohet si i bazuar në shkaqe, shefi i shërbimit urdhëron mbajtjen shtruar të personit në mënyrë të pavullnetshëm dhe i referon titullarit të institucionit plotësimin e kërkesës drejtuar Gjykatës të Rrethit Gjyqësor brenda 48 orësh për vazhdimin ose jo të procedurës për trajtim të pavullnetshëm.

Data: _____ Ora: _____ Firma: _____

Kopje e kërkesës dhe informacioni mbi procedurat e trajtimit të pavullnetshëm u është vënë në dispozicion:

Pacientit

Familjarëve të afërt

Përfaqësuesit ligjor

Data e marrjes së vendimit nga ana e Gjykatës të Rrethit Gjyqësor: _____

Vlerësimi i procedurave të trajtimit të pavullnetshëm: I drejtë I padrejtë

Data e revokimit të vendimit të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor: _____

Gjatë të gjitha fazave të trajtimit të pavullnetshëm, pacienti dhe familjarët e afërt dhe/ose përfaqësuesi ligjor duhet të informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi procedurat e ndjekura, si dhe të gjitha ndërhyrjet e marra gjatë kësaj periudhe duhen dokumentuar në kartelën klinike.

Në të gjitha rastet kur bien shkaqet për trajtim të pavullnetshëm, pacienti duhet të japë miratimin e tij/saj për dakordësinë mbi trajtimin dhe të firmosë miratimin e informuar që gjendet në brendësi të kartelës klinike.

SHËRBIMI I SHËNDETIT MENDOR I SPECIALIZUAR ME SHTRETËR

Formular Tip A2

Adresa: _____ email: _____ Data: _____

KËRKESË PËR SHQYRTIM TË VENDIMIT PËR TRAJTIM TË PAVULLNETSHËM

Drejtuar: Gjykata e Rrethit Gjyqësor _____

Kërkuesi: Shërbimi i Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër _____

Titullari i institucionit _____

Objekti: Trajtim i pavullnetshëm

Baza ligjore: Ligji Nr.44/2012, "Për shëndetin mendor", i ndryshuar.

Z. Gjyqtar,

Në Shërbimin e Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër, pacienti me emrin _____ lindur më _____, banues në _____, me nr. karteles klinike _____, është i shtruar pranë shërbimit tonë që nga _____, ora _____ dhe statusi i shtrimit është _____ (vullnetshëm/i pavullnetshëm).

Pacienti u referua në shërbimin tonë prej:

- Të afërmve
- Policisë
- Personave të panjohur
- Tjetër _____

Mjeku specialist, Dr. _____, pasi ka kryer personalisht ekzaminimin dhe vlerësimin e pacientit/pacientes _____, ka vendosur shtrimin e pavullnetshëm.

Pacienti

- Zotëron zotësi për të vepruar
- Nuk zotëron zotësi juridike për të vepruar
- Nuk ka informacion mbi zotësinë juridike për të vepruar

Gjendja e shëndetit të tij mendor në momentin e shtrimit paraqitej si më poshtë:

Plani i trajtimit i propozuar ishte si më poshtë:

Plani i trajtimit i rekomanduar u refuzua nga pacienti. Meqenëse pacienti paraqet rrezik për veten ose të tjerët, mjeku specialist Dr. _____, vendosi të zbatojë trajtimin e pavullnetshëm, i cili u rivlerësua nga një mjek tjetër specialist dhe u miratua nga Shefi i Shërbimit / Institucionit (ose personi i autorizuar prej tij), Dr. _____, në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi për shëndetin mendor. Në këto kushte i kërkojmë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të vlerësojë për vazhdimin ose jo të procedurës së trajtimit të pavullnetshëm.

Drejtuesi i Shërbimit/Institucionit

SHËRBIMI I SHËNDETIT MENDOR TË SPECIALIZUAR ME SHTRETËR

Informacion për pacientit

Formular Tip A3

TRAJTIMI I PAVULLNETSHËM

1. Emri i pacientit	
2. Emri i mjekut përgjegjës për trajtimin tuaj	
3. Emri i shërbimit shëndetit mendor të specializuar me shtretër	
4. Data ku ka fillur procesi i trajtimit të pavullnetshëm	

Pse po e marr këtë trajtim?

Pas shtrimit tuaj, mjeku përgjegjës për trajtimin tuaj dhe anëtarët e tjerë të stafit ju kanë informuar për planin e trajtimit që ata mendojnë se ju nevojitet, megjithatë ju e refuzuat trajtimin. Në këtë situatë lind nevoja e zbatimit të procedurës për trajtim të pavullnetshëm, sipas parashikimeve në kuadrit ligjor në fuqi për shëndetin mendor. Kjo do të thotë që dy mjekë, sipas mendimit të tyre të pavarur profesional, mendojnë se trajtimi i zgjedhur për ju është në përputhje me diagnozën dhe llojin e shërbimeve që ky institucion mund të ofrojë.

Për sa kohë duhet ta marr këtë trajtim?

Ju do të merrni këtë trajtim në qënë i shtruar në këtë shërbim derisa mjeku përgjegjës për trajtimin tuaj të përcaktojë që jeni mjaftueshëm mirë për të vazhduar trajtimin në komunitet. Nëse, ndërkohë, gjendja juaj shëndetësore nuk përmirësohet, ose nuk e pranoni vullnetarisht trajtimin, atëherë brenda tre ditëve nga data e fillimit të trajtimit, shërbimi do t'i dërgojë gjykatës së rrethit një kërkesë për rishikimin e trajtimit tuaj të pavullnetshëm. Ju do të merrni një kopje të kësaj kërkesë. Gjatë kësaj periudhe, si dhe në rast se gjykata e rrethit miraton trajtimin e pavullnetshëm, ju nuk duhet të largoheni nga shërbimi. Nëse përpiqeni të largoheni, stafi mund t'ju ndalojë, dhe nëse largoheni, mund t'ju kthejnë përsëri në shërbim.

A kam të drejtë të ankojem?

Ju mund të flisni me mjekun tuaj përgjegjës për trajtimin ose me ndonjë anëtar të stafit në çdo moment që mendoni se vendimi për trajtim të pavullnetshëm është i padrejtë, ose nëse mendoni se jeni gati që të pranoni trajtimin në baza vullnetare. Ju /anëtarë të familjes suaj dhe /ose përfaqësuesi juaj ligjor, gëzoni të drejtën për t'i kërkuar gjykatës të rishikojë vendimin për trajtimin e pavullnetshëm.

Informimi i familjarit tuaj më të afërt

Një kopje e këtij formulari informues, si dhe e kërkesës për në gjykatë do t'i jepet dhe familjarit tuaj më të afërt. Në rastin tuaj, si familjari juaj më i afërt është identifikuar:

Në rast se ju nuk dëshironi që ky person i identifikuar si familjari juaj më i afërt të informohet në lidhje me gjendjen tuaj shëndetësore, thuajini mjekut tuaj.

DEKLARATË PRANIMI /MIRATIMI

Për shtrimin në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër

Emri i pacientit: _____

Mjeku im kurues _____, më ka rekomanduar se duhet të shtrohem në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër _____, me qëllim sigurimin e kujdesit dhe trajtimin e duhur shëndetësor, pasi mi ka bërë të ditura arsyet se përse shtrimi në këtë shërbim është i domosdoshëm, duke përfshirë përfitimet dhe rreziqet.

Unë e jap aprovimin/miratimin tim që të shtrohem pranë këtij shërbimi pasi jam informuar në mënyrë të plotë dhe të përshtatshme se shtrimi është mënyra e vetme e përmirësimit të gjëndjes time mendore dhe se gjendja ime kërkon trajtim të menjëhershëm dhe se trajtimi mund të merret me shtrimin në këtë shërbim të shëndetit mendor.

Mjeku kurues më ka sqaruar se koha e qëndrimit i shtruar në këtë shërbim do të jetë sa më e shkurtër të jetë e mundur aq sa gjendja shëndetësore do lejojë trajtimin tim jashtë këtij shërbimi.

Më është bërë e qartë se gjatë qëndrimit tim në spital unë mund të vizitohem rregullisht prej familjarëve të mi dhe njerëzve të afërt për mua, përveç rasteve kur gjendja ime shëndetësore nuk e lejon dhe mjeku im e shikon të arsyeshme që nuk është momenti i përshtatshëm për vizita.

Jam informuar gjithashtu, se unë nuk mund të dal nga pavioni pa lejen e mjekut, dhe nuk mund të shkoj në shtëpi për një apo disa ditë gjatë qëndrimit në spital pa lejen e drejtuesve të shërbimit.

Vendimi im për të pranuar/miratuar shtrimin, në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër _____, është marrë me vullnetin tim të plotë, dhe unë mund të anulloj aprovimin/miratimin tim kurdoherë në të ardhmen.

Mua më është dhënë një kopje e këtij formulari pranimi.

Personi qe jep aprovimin

Data _____

Emër Mbiemër: _____

Firma: _____

SHËRBIMI I SHËNDETIT MENDOR I SPECIALIZUAR ME SHTRËTËR

Formular Tip A1

FORMULAR PËR SHTRIM TË PAVULLNETSHËM

EMRI DHE MBIEMRI (me shkronja shtypi)

Nr. Regjistri.	

Data: _____

Ora: _____

Burimi i referimit:

Emri dhe kodi i personit referues: _____

- | | |
|---------------|----------------------|
| 0. N.D | 5. Policia |
| 1. Pacienti | 6. Mjeku i familjes |
| 2. Familjarë | 7. Psikiatër |
| 3. Fqinj | 8. Specialist tjetër |
| 4. Vetë stafi | 9. Të tjerë |

Zotësia për të vepruar:

Po

Jo

N.D

ARSYET E REFERIMIT NË SHËRBIM:

(Sipas personit referues)

Firma e personit referues.

GJENDJA AKTUALE DHE PËRSHKIMI I SIMPTOMATIKËS:

Mjeku specialist, Dr. _____, pasi ka kryer personalisht ekzaminimin rekomandoi shtrimin, por pacienti refuzoi shtrimin e vullnetshëm. Meqënëse pacienti paraqet rrezikshmëri për veten apo të

tjerët, dhe përmbush kriteret në bazë të Ligjit 44/2012, i ndryshuar, vendos shtrimin e pavullnetshëm dhe merr përsipër njoftimin e shefit të shërbimit brenda 24 orëve nga kryerja e vlerësimit fillestar.

Data: _____ Ora: _____ Firma: _____

RIVLERËSIMI I VENDIMIT PËR SHTRIM TË PAVULLNETSHËM:

Shefi i shërbimit Dr. _____, udhëron mjekun specialist Dr. _____, për rivlerësimin e gjëndjes shëndetësore.

Data: _____ Ora: _____ Firma: _____

Mjeku specialist, Dr. _____ pasi ka kryer personalisht rivlerësimin e gjëndjes shëndetësore, konstatoi se shtrimi i pavullnetshëm i vendosur nga mjeku i parë, është:

I bazuar

I pabazuar

Kanë rënë shkaqet

Data: _____

Ora: _____

Firma: _____

Nëse Shtrimi i pavullnetshëm vlerësohet si i bazuar në shkaqe, shefi i shërbimit urdhëron mbajtjen shtruar të personit në mënyrë të pavullnetshëm dhe i referon titullarit të institucionit plotësimin e kërkesës drejtuar Gjykatës të rrethit gjyqësor brenda 48 orësh për vazhdimin ose jo të procedurës për shtrim të pavullnetshëm.

Data: _____ Ora: _____ Firma: _____

Kopje e kërkesës dhe informacioni mbi procedurat e shtrimin e pavullnetshëm u është vënë në dispozicion:

Pacinetit

Familjarëve të afërt

Përfaqësuesit ligjor

Data e marrjes së vendimit nga ana e Gjykatës të Rrethit Gjyqësor: _____

Vlerësimi i procedurave të shtrimit të pavullnetshëm: I drejtë I padrejtë

Data e revokimit të vendimit të Gjykatës të rrethit gjyqësor: _____

Gjatë të gjitha fazave të shtrimit të pavullnetshëm, pacienti dhe familjarët e afërt dhe/ose përfaqësuesi ligjor duhet të informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi procedurat e ndjekura, si dhe të gjitha ndërhyrjet e marra gjatë kësaj periudhe duhen dokumentuar në kartelën klinike.

Në të gjitha rastet kur bien shkaqet për shtrim të pavullnetshëm, pacienti duhet të japë miratimin e tij/saj për vazhdimësinë e shtrimit dhe të firmosë miratimin e informuar që gjendet në brendësi të kartelës klinike.

SHËRBIMI I SHËNDETIT MENDOR I SPECIALIZUAR ME SHTRITËR

Formular Tip A2

Adresa: _____ email: _____ Data: _____

KËRKESË PËR SHQYRTIM TË VENDIMIT PËR SHTRIM TË PAVULLNETSHËM

Drejtuar: Gjykata e Rrethit Gjyqësor _____

Kërkuesi: Shërbimi i Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër _____

Titullari i institucionit _____

Objekti: Shtrim i pavullnetshëm

Baza ligjore: Ligji nr.44/2012, "Për shëndetin mendor", i ndryshuar .

Z. Gjyqtar,

Pranë Shërbimit të Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër _____, ndodhet i shtruar që prej datës _____, ora _____, pacienti _____, lindur më _____, në _____, dhe banues në _____, me nr.kartele _____.

Pacienti u referua në shërbimin tonë prej:

- Të afërmve
- Policisë
- Personave të panjohur
- Tjetër _____

Mjeku specialist, Dr. _____, pasi ka kryer personalisht ekzaminimin e pacientit/pacientes _____, ka vendosur shtrimin e pavullnetshëm.

Pacienti

- Zotëron zotësi për të vepruar
- Nuk zotëron zotësi juridike për të vepruar
- Nuk ka informacion mbi zotësinë juridike për të vepruar

Gjendja e shëndetit të tij mendor në momentin e shtrimit paraqitet si më poshtë:

Në këto kushte atij ju rekomandua të shtrohej në shërbimin tonë por pacienti refuzoi shtrimin e vullnetshëm.

Meqënëse pacienti paraqet rrezikshmëri për veten apo të tjerët, mjeku specialist Dr. _____ vendosi të aplikojë shtrimin e pavullnetshëm, i cili u rivlerësua nga një mjek i specializuar tjetër dhe u miratua prej Drejtuesit të Shërbimit/Institucionit (ose personit të autorizuar prej tij), Dr. _____, në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi për shëndetin mendor, në këto kushte i kërkohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të vlerësojë për vazhdimin ose jo të procedurës së shtrimit të pavullnetshëm.

Drejtuesi i Shërbimit/Institucionit

SHËRBIMIN SHËNDETIT MENDOR TË SPECIALIZUAR ME SHTRETËR

Informacion për pacientit

Formular Tip A3

SHTRIMI I PAVULLNETSHËM

1. Emri i pacinetit	
2. Emri i mjekut përgjegjës për vlerësimin tuaj	
3. Emri i Shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër	
4. Data ku ka fillur shtrimi i pavullnetshëm	

Pse jam në spital?

Ju po mbaheni në spital sipas kriterëve të parashikuara në kuadrin ligjor për shëndetin mendor, i ndryshuar. Kjo do të thotë se dy mjekë mendojnë se ju keni një sëmundje mendore dhe për këtë arsye është e nevojshme që ju të qendroni në spital për të marrë trajtimin dhe shërbimin e përshtatshëm.

Sa gjatë duhet të qëndroj në spital?

Ju do të qëndroni në spital derisa mjeku përgjegjës për trajtimin tuaj të gjykojë se jeni mjaftueshëm mirë për të dalë nga spitali. Nëse kushtet tuaja shëndetësore nuk përmirësohen, ose ju nuk pranoni shtrimin në mënyrë të vullnetshme, atëherë brenda tre ditëve nga data e shtrimit, spitali do i dërgojë gjykatës së rrethit gjyqësor një kërkesë për mbajtjen tuaj në spital. Ju do të merrni një kopje të kësaj kërkesë.

Gjatë kësaj periudhe, si dhe në rast se gjykata e rrethit gjyqësor aprovon shtrimin e pavullnetshëm, ju nuk duhet të largoheni nga spitali. Nëse ju përpiqeni të largoheni, atëherë stafi mund t'ju ndalojë, dhe në rast se largoheni, ju mund të silleni sërish pas në spital.

Çfarë trajtimi do më japin gjatë kësaj kohe?

Mjeku përgjegjës për shtrimin tuaj dhe anëtarë të tjerë të personelit do t'ju informojnë mbi cdo trajtim që ata mendojnë se ju keni nevojë. Në rast se nuk pranoni planin e trajtimit, do të zbatohen procedurat e trajtimit të pavullnetshëm.

Informimi i familjarit tuaj më të afërt

Një kopje e këtij formulari informues, si dhe e kërkesës për në gjykatë do t'i jepet dhe familjarit tuaj më të afërt. Në rastin tuaj, si familjari juaj më i afërt është identifikuar:

--

Në rast se ju nuk dëshironi që ky person i identifikuar si familjari juaj më i afërt të informohet në lidhje me gjendjen tuaj shëndetësore, thuajini mjekut tuaj.